

ë, lënda e Behajdinit është regjistruar më numrin BLG-802388-01.

Burimet: deklarata M.K, FDH-18930; deklarata N.N, FDH-18932; deklarata N.A, FDH-35015; AIS, *Zona...*, 25, FDH-16913; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sadri (Sali) Thaqi

(4.12.1949, shqiptar nga Kramoviku/Kramovik, komuna e Rahovec/Orahovac, bujk, shtatë fëmijë)

Forcat serbe e ngritën një postbllok në fshatin Kramovik, gjë që e detyroi bashkëshorten e Sadriut, Kumrijen, që me katër fëmijë të braktisnin fshatin më 14.06.1998. Në shtëpi mbetën Sadriu me të bijat Shahen dhe Almen si dhe të birin Bekimin. Tri ditë më vonë, më **17.06.1998**, forcat serbe nisën me bombardimin e fshatit **[Kramovik]**. Në çastin kur Sadriu doli në oborr, një predhë eksplodoi shumë afër tij. Ciflat e saj e qëlluan në kokë dhe e lanë të vdekur në vend. Ditën tjetër, herët në mëngjes rreth orës 2:00 pas mesnate, familjarët e varrosën Sadriun në varrezat lokale, me ndihmën e komshinjve. Atje prehet edhe sot.

Burimi: deklarata K.T, FDH-17934.

Idriz (Avdi) Hoti

(21.02.1936, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, bujk, pesë fëmijë)

Idrizi ka qenë i martuar me një boshnjake të përkatësisë myslimane. Jetonin në Gjakovë/Đakovica. Fëmijët e tyre jetonin dhe punonin në Zvicër dhe Gjermani. Ai e përkrahte LDK-në. Ditën e pacaktuar të muajit **qershor apo korrik** të vitit **1998**, Idrizi shkoi me biçikletë për një vizitë të fafesisë, në fshatin e lindjes në **Dejné/Danjane**. Policia serbe e ndali atë në një postbllok. E keqtrajtoi fizikisht, duke e akuzuar se e furnizonte UÇK-në me para e cigare. E kërcënuan me fjalë që do t'ia vrisnin tërë familjen, nëse ditën e ardhshme nuk do të kthehej në shtëpi me të njëjtën rrugë. Idrizi natën e kaloi në shtëpinë e të afërmit dhe ditën tjetër, diku nga mesdita, u përshëndet nga ai duke i thënë se po shkonte në "zonën e Ramush Haradinajt", për të

aderuar në UÇK. Nga ajo ditë, familjarët nuk kishin kurrfarë njohuri për Idrizin. Pas përfundimit të luftës, ata mësuan nga një i afërm që ai e kishte vërejtur Idrizin të kalonte nëpër Cërmjan/Crmljane, i cili ishte nën kontrollin e UÇK-së. Në rajon zhvilloheshin luftimet ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Ekspertët serb të mjekësisë ligjore e kanë gjetur trupin e Idrizit më 12.09.1998, në kanal in e ***Liqenit të Radoniqit/Radonjičkojezero***. Konstatuan se Idrizin e kishin vrarë me një plumb në kokë. Policia serbe e ka varrosur Idrizin në fshatin Piskotë/Piskote, duke e evidentuar si PP [person i panjohur]. Vetëm në muajin dhjetor të vitit 2008, familjarët e Idrizit kanë mësuar se mbetjet mortore të Idrizit janë gjetur dhe identifikuar. Idrizin e kanë varrosur në varrezat e qytetit të Gjakovës/Đakovica, më 25.12.2008.

Burimet: deklarata E.H, FDH-33005; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);) OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

Azer (Kadri) Tarjani

(2.04.1955, shqiptar nga Pirana/Pirane, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, tre fëmijë)

Azeri, bashkëshortja Sahide dhe fëmijët e tyre jetonin në Piranë/Pirane. Pranë shtëpisë së tyre jetonin vëllezërit e Azerit, Zeneli dhe Ukshini, me familjet e veta. Azeri dhe Zeneli kanë qenë vëllezërit binjakë. Në datën **2.07.1998**, Zeneli e ka organizuar dasmën për djalin Vetonin. Nga ora 12:00, Azeri me Zenelin dhe motrën Xhevrijen u nisën me makinë për në **Drenoc/Drenovac**, për ta marrë nusen e Vetonit. Në postbllokun e UÇK-së, në hyrje të fshatit, ata u ndalën nga katër ushtarë. E njohën një nga ta [emri i tij është i njohur për FDH], sepse me të përpara i kishin disa mosmarrëveshje rreth tokës. Ushtarët i legjitimuan Azerin, Zenelin dhe Xhevrijen dhe, më pas, u lejuan që të vazhdonin rrugën. Gjatë kthimit, ata sërish u ndalën në të njëjtin postbllok. Azerin e nxorën nga vetura, ndërsa Zenelit, Xhevrijes dhe nuses